“Çdo gjë që deh në sasi të madhe, edhe sasia e vogël e saj është e ndaluar.”

Xhabir ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Çdo gjë që deh në sasi të madhe, edhe sasia e vogël e saj është e ndaluar.”
[Hasen] [Transmetojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu, ibn Maxhe dhe Ahmedi]

Profeti në këtë hadith sqaroi se çdo pije ose ushqim, që shkakton humbjen e kontrollit të aftësive mendore, kur konsumohet në sasi të mëdha, atëherë konsumimi i një sasie të vogël prej tij është i ndaluar, edhe nëse ajo nuk e turbullon mendjen.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/66036